REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8180/1 **Prot.** **Lushnje, më** 19/09 **/2025**

PROJEKT-VENDIM
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2025
NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA
(Miratuar me VKB nr.126 datë 26.12.2024)

Nr. 88

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____ 2025, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë **Mbi një shtesë në Buxhetin e Vitit 2025",** mbështetur në Ligjin nr. 139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, neni 54 gërma dh, në Ligjin Nr.115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", në Ligjin nr.9936 datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqiperisë", i ndryshuar, në Udhëzimin nr.9 datë 20.03.2018 të Ministrisë së Financave "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit" pika 103 të ndryshuar, Udhëzimi Plotësues nr.2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit Viti 2025",

PROPOZOJMË:

1. Të rriten të ardhurat e trashëguara të buxhetit për vitin 2025 për vlerën **127,100,000 lekë.**.
2. Të rriten shpenzimet për vitin 2025 për vlerën **127,100,000 lekë.**.

Rritja do të shkojë në:

a. Në **Bashkine Lushnje**, në programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse" për 1,500,000 lekë, (00-01-AA129-600) V328AAB

b. Në **Bashkine Lushnje**, në programin AD129 "Zhvillim bujqesor, Ekonomik dhe Social" për 500,000, (00-01-AD129-606) V066AAB

c. Në **Bashkine Lushnje**, në programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse" për 15,000,000 lekë, (00-01-AA129-600) V111AAA dhe 2,500,000 lekë (00-01-AA129-601) V111AAA.

d. Në **Bashkine Lushnje**, në programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse" p 1,200,000 lekë, (00-01-AA129-231) për "Blerje automjeti për nevojat e Policisë Bashkiake (kodi do të celet nga Ministria e Financave)

e. Në **Ndërmarrjen "Qendra e Kulturës & Klubi i Futbolli"** për 1,000,000 lekë në programi AE129 (Art, kulturë sport) për "Blerje mobilje (rafte) për Bibliotekën e Qytetit" në vle 500,000 lekë (00-01-AE129-231) (programi 08220) dhe "Blerje rafte për dhomat e zhveshjes n Palestrën e Krutjes" në vlerë 500,000 lekë (00-01-AE129-231) (programi 08130)

f. Në **Qendrën e Arsimit**, në programin AC129 "Arsimi" për 1,000,000 lekë, (00-01-AC129 231- P912ABK.) Blerje mjet transporti kamioncin"

g. Në **Ndërmarrjen e Pasurisë Publike**, AB129 për produktin "Rrjeti i ndricimit rrugor publi urban i mirëmbajtur" për 14,500,000 lekë, (00-01-AB129-602) V644AAB

h. Në **Ndërmarrjen e Pasurisë Publike**, AB129 për produktin V452AAB "Rrjet Rrugor Rural mirëmbajtur". për 20,000,000 lekë, (00-01-AB129-602) V452AAB

i. Në **Bashkinë Lushnje** në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" (00-01-AB129 231) për 8,400,000 lekë për projektin "Rikonstruksion i rrugës "Hoxhallarëve" në Ardenicë

j. Në **Bashkinë Lushnje** në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" (00-01-AB129 231) për 35,500,000 lekë për projektin "Rikonstruksion i njësisë Administrative Krutje"

k. Në **Bashkinë Lushnje** në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" (00-01-AB129 231) për 12,500,000 lekë për projektin "Sistemim asfaltimi i segmentit rrugor "Rruga e Trashallarëve" në Ngurrëz e Vogel, Njesia administrative Krutje"

l. Në **Bashkinë Lushnje** në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" (00-01-AB129 231) për 13,500,000 lekë për projektin "Ndërhyrje në infrastrukturën e segmenteve rrugorë në Çukas të Ri, rruga Miftar Kaja, Bankinë + rruga Bixheket, Bankinë + Rruga Degëzimi djathtas Bankinë"

Për projektet e reja kodet e projekteve do të celen nga Ministria e Financave pas miratimi në Këshillin Bashkiak.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Financë-Buxhetit dhe Ndërmarrja e Pasurisë Publike, Qendra e Kulturës Klubi i futbolli, Qendra e Arsimit.

4. Vendimi hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Grupi i Menaxhimit Strategjik :

Drejtoria Financë –Buxhetit

Ervisa Çuko

Drejtoria e të Ardhurave Vend

Donald Nushi

Dr e Përgj e Shërb Publike e Zhvillimit Urban dhe rural

Mimoza Haxhiu

Drejtoria Juridike

Bedri Hida

Ndërmarrja Pasurisë Publike

Evis Qyra

Qendra e Arsimit

Muarrem Sharka

Qendra e Kulturës & Klubi i Futbolli.

Brizida Dervishi

KRYETARE E BASHKISË

Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 8180 Prot. **Lushnje,më** 19/09 **/2025**

RELACION
KËSHILLIT BASHKIAK
MBI NJË SHTESË NË BUXHETIN E VITIT 2025
NGA TË ARDHURAT E TRASHËGUARA
(Miratuar me VKB nr.126 datë 26.12.2024)

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltar!

Bazuar në Ligjin Nr .139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", Ligjin Nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin Nr. 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", Udhëzimi Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025", Udhëzimit Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit", si dhe mbas rakordimit të ardhurave të trashëguara nga viti 2024 për në vitin 2025 te cilat ishin 566,697,377 lekë, nga të cilat 180,000,000 lekë janë miratuar dhe shpërndarë në buxhetin e vitit 2025 si dhe shtesa në buxhet nga te ardhurat e trashëguara sipas VKB nr 26 datë 25.02.2025 me vlerë 33,971,939 lekë,VKB nr 34 datë 01.04.2025 në vlerë 1,200,000 lekë, VKB nr 47 datë 30.05.2025 në vlerë 31,183,182 lekë, VKB nr 58 datë 30.06.2025 me vlerë 6,320,000 lekë dhe VKB nr 76 datë 23.07.2025 me vlerë 66,796,000 lekë nga të ardhurat e trashëguara kemi ende fonde të pashpërndara nga kapitulli 01 dhe 05.

Pasi miratimit dhe shpërndarjes sipsa vendimeve të mesiperme dhe rakordimit me degen e thesarit nga kapitulli 01 kemi të pa shperndara 179,986,265 lekë nga te cilat do te shpërndajmë **127,100,000 lekë**. Nisur nga kërkesa e disa drejtues programesh, pas diskutimeve në mbledhjen e GMS-së, u vendos të bëjmë një shtesë në buxhetin e vitit 2025 në disa programe buxhetore për këto arsye:

1. Sipas vendimit nr 483 datë 02.09.2025 të Këshillit të Ministrave për "Dhënie shpërblimi personelit të angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve gjatë vitit 2025" për strukturat e përcaktuara në shkronjën "d" (Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në bashki), të pikës 2 (Shpërblehen punonjesit e: d. Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin në bashki) të këtij vendimi, përballohet nga buxhetet përkatese të njesive të vetëqeverisjes vendore. Në shërbimin zjarrfikës aktualisht janë 16 punonjës të cilët përfitojnë të shpërblehen me një pagë mujore bruto për angazhimin e tyre në operacionet e shuarjes së zjarreve. Për këtë arsyer është e nevojshme të bëhet një shtesë ne buxhetin e vitit 2025 prej 1,500,000 lekë nga të

ardhurat e trashëguara në programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse" produkti V328AAB (00-01-AA129-600)

- Të shtohen të ardhurat e Bashkisë me **1,500,000** lekë për shpërblim për punonjesit e shërbimit zjarrfikës në Programin AA129-00-01-600-V328AAB.

2. Të bëhet një shtesë në programin AD129 "Zhvillim bujqesor, Ekonomik dhe Social" pasi pas rakordimit fondi i mbetur për pagesat e qerave të pastreha është i pamjaftueshem për mbulimin e shpenzimeve për rastet e paraqitura në Bashkine Lushnje (raste të grave të dhunuara të cilat aplikojnë për ndihmë) dhe që mbulohen nga ky fond. Të bëhet shtesa në Bashkinë Lushnje në programin AD129 "Zhvillim bujqesor, Ekonomik dhe Social" (00-01-AD129-606) për 500,000 lekë, "Familje në nevojë të subvencionuar për qeratë"

- Të shtohen të ardhurat e Bashkisë me **500,000** lekë për shpenzime qira të pastrehë AD129-00-01-606-V066AAB

3. Të bëhet shtesa në programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse" në produktin V111AAA për artikullin 00-01-600 në vlerën 15,000,000 lekë dhe për produktin V111AAA për artikullin 00-01-601 në vlerë 2,500,000 lekë për sigurime shoqërore dhe shëndetesore pasi të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2025 janë të pamjaftueshme për të mbuluar të gjitha pagat gjatë muajve në vazhdim deri në fund të vitit. Deri në muajin Shtator është përdorur i gjithë plani dhe limiti nga kapitulli 01 për këtë produkt (00-01-600-V111AAA). Pas u bë rakordimi me thesarin, nga të ardhurat e trashëguara nga viti i kaluar kërkojmë të bëhet një shtesë në buxhet për këtë produkt V111AAA në artikullin 600 dhe 601.

Llogaria	Buxheti	Faktike	Fond i lire
129-00-2129001-B1-AA129-600-T-0922-V111AAA	106,621,791.00	106,621,069.00	722

- Të shtohen të ardhurat e Bashkisë me **17,500,000** lekë për paga dhe sigurime per programin AA129 "Menaxhimi dhe Shërbimet Mbështetëse": 15,000,000 lekë për AA129-00-01-600-V111AAA dhe 2,500,000 lekë për AA129-00-01-601-V111AAA

4. Bazuar në kërkesën për blerje automjeti nr 7529 prot datë 02.09.2025 nga Drejtoria e Policise Bashkiake për realizimin e detyrave të përcakuara në zbatim të nenit 7, pika 3, nenit 8/c, të Ligjit nr.89/2022 "Për Policinë Bashkiake", si edhe kreut III, të V.K.M. Nr. 494, datë 24.8.2023 "Për miratimin e uniformës, shenjave dalluese dhe modelit të dokumentit individual të identifikimit, ngjyrës, shenjave dhe përdorimit të mjeteve lëvizëse të Policisë Bashkiake" të cilët kërkojnë blerjen e një automjeti 6+1 në menyrë që ti shërbej për kryerjen e detyrave në kohë. Ky automjet nuk është parashikuar në Buxhetin e vitit 2025 dhe kërkojmë të bëjme një shtesë në buxhetin e vitit 2025 për të mundësuar blerjen e një automjeti 6+1 sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe llogaritjen e fondit limit për porcedurën e prokurimit me objekt "Blerje automjeti për nevojat e

Policisë Bashkiake". Vlera e parashikuar për blerjen e një automjeti furgon 6+1 është 1,200,000 lekë.

- Të shtohen të ardhurat e Bashkisë me **1,200,000** lekë për "Blerje automjeti për nevojat e Policisë Bashkiake" në Programin AA129-00-01-231. Kodi do të celet nga Ministria e Financave pas miratimit në Këshill.

5. Në programin AE129 (Art, kulturë sport) që mbulohet nga Ndërmarrja Qendra e Kulturës & Klubi i Futbolli. Shtesa të shkojë në program në artikullin 231, për Blerje mobilje (rafte) për Bibliotekën e Qytetit dhe rafte për dhomat e zhveshjes në Palestrën e Krutjes në vlerën 1,000,000 lekë, nga të cilat 500,000 leke (AE129-00-01-231)(08220) do të përdoren për blerje raftesh për bibliotekën pasi është e nevojshme për të sistemuar sa më mirë librat që ndodhen në të dhe 500,000 leke (AE129-00-01-231)(08130) do të përdoren për blerje raftesh në dhomat e nderrimit të sportisteve të cilët trajnohen dhe zhvillojnë ndeshjet në këtë palestër. Kodi do të celet nga Ministria e Financave pas miratimit në Këshill per secikin nga projektet e mesiperme

-Të shtohen të ardhurat e Qendra e Kulturës & Klubi i Futbolli për **1,000,000** lekë Blerje mobilje (rafte) për Biblotekën e Qytetit ne programin (AE129-00-01-231) (08220)për 500,000 lekë dhe 500,000 lekë për blerje rafte për dhomat e zhveshjes në Palestrën e Krutjes në programin (AE129-00-01-231) (08130). Kodi do të celet nga Ministria e Financave pas miratimit në Këshill.

6. Bazuar në kërkesen për alokim fondi për "Blerje automjet frigoriferik" nëpermjet shkresës me nr 561 prot date 17.07.2025 në Ndërmarrjen Qendra e Arsimit e cila kërkon një shtesë në programin AC129 "Arsimi" në artikullin 231, në projektin "Blerje automjet frigoriferik" AC129-00-01-231 në vlerën 1,000,000 lekë. Ky automjet frigoriferik i tipit auto-karro me frigorifer do të shërbejë për shpërndarjen e produkteve ushqimore në kopshtet dhe cerdhe përkatese.

- Të shtohen të ardhurat e Ndërmarrjes "Qendra e Arsimit" me **1,000,000** lekë për "Blerje automjet frigoriferik" në programin AC129-00-01-231- P912ABK.

6. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 602 në Ndërmarjen e Pasurisë Publike të shtohet buxheti me 14,500,000 lekë për ndricimin rrugor në zona urbane. Shtesa do të bëhet në programin AB129 për produktin "Rrjeti i ndricimit rrugor publik urban i mirëmbajtur" V644AAB-00-01-602 në vlerë totale 14,500,000 lekë, me këto fonde do të bëhet blerje materiale (shtylla, koka ndricimi 150W, 100W 50W, tel kabull, automate, llampa led, etj) për mirëmbajtjen e rrjetit te ndricimit rrugor në zona të banuara urbane.

- Të shtohen të ardhurat e Ndërmarrjes se Pasurise Publike me **14,500,000** lekë në programin AB129 për ndricimin rrugor në zona urbane në produktin V644AAB-00-01-602

7. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 602 në Ndërmarjen e Pasurisë Publike të shtohet buxheti me 20,000,000 lekë V452AAB "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur". Këtu do të bëhen nderhyrje në shtrimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve ne zonat kodrinore dhe rruget e varrezave te fshatrave me shtresa betoni si më poshtë:

   a) Degëzimi i rrugës "Pasho Zoto" (me gjatësi 80 ml dhe gjerësi 3m)
   b) Rruga e "Varrezave" në fshatin Golem i Madh (me gjatësi 490 ml gjerësi 3m)
   c) Rruga e "Varrezave Hajdaraj+ përballë" (me gjatësi 320 ml gjerësi 3m)
   d) Rruga Cameria "Hilet" në Kolonjë (me gjatësi 120 ml gjerësi 3m)
   e) Rruga e "Varrezave" në Karbunarë e Vogel (me gjatësi 350 ml gjerësi 3m)
   f) Rruga "Demirasi" në fshatin Hysgjokaj (me gjatësi 370 ml gjerësi 3m)
   g) Rruga "Hoxhallinjeve" në fshatin Gramsh (me gjatësi 400 ml gjerësi 3m)
   h) Rruga e "Vidhes" në fshatin Zhamë (me gjatësi 400 ml gjerësi 3m)
   i) Rruga "Teki Libohova" (me gjatësi 165 ml gjerësi 3m)
   j) Rruga "Migjeni" (me gjatësi 100 ml gjerësi 3m)
   k) Rruga "Sef Hoxhaj" në fshatin Allprenaj (me gjatësi 350 gjerësi 3m)

   - Të shtohen të ardhurat e Ndërmarrjes se Pasurise Publike me 14,500,000 lekë në programin AB129 në "Rrjet Rrugor Rural i mirëmbajtur" në produktin V452AAB-00-01-602

Në njësinë Administrative Krutje dhe Njësinë Administrative Kolonje gjatë dëgjesave publike të zhvilluara per hartimin e buxhetit 2025 u paraqiten kërkesa për rikonstruksionin e rrugëve kryesore të këtyre njësive. Nga të ardhurat e trasheguara të bëhet shtesa për projektet e reja të cilat nuk ishin parashikuar në Buxhetin e vitit 2025. Këto rrugë janë rrugë kryesore të amortizuara dhe kërkojnë nderhyrje.

1. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 231 në Bashkinë Lushnje, për projektin me objekt "Rikonstruksion i rrugës "Hoxhallarëve" në Ardenicë, Njësia Administrative Kolonjë në vlerën 8,400,000 lekë (AB129-00-01-231) (dëgjesa publike sipsa procesverbalit nr 974 datë 05.11.2024 mbajtur në Njesinë Administrative Kolonjë)
2. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 231 në Bashkinë Lushnje, për projektin me objekt "Rikonstruksion i njësisë Administrative Krutje" në vlerë 35,500,0000 lekë (AB129-00-01-231) Ky projekt është hartuar në kuadër të rijetësimit të Qendrave të Njësive Administrative dhe nisur nga gjendja ekzistuese e godinës e cila paraqet amortizim të konsiderueshëm.
3. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 231 në Bashkinë Lushnje, për projektin me objekt "Sistemim asfaltimi i segmentit rrugor "Rruga e Trashallarëve" në Ngurrëz e Vogel, Njësia administrative Krutje" në vlerë 12,500,000 lekë (AB129-00-01-231) (dëgjese publike sipas procesverbalit nr 490 date 06.011.2024 Njesia Administrative Krutje)
4. Në programin AB 129 "Shërbimet Publike Komunitare" artikulli 231 në Bashkinë Lushnje, për projektin me objekt "Ndërhyrje në infrastrukturën e segmenteve rrugorë në Çukas të Ri, rruga Miftar Kaja, Bankinë + rruga Bixheket, Bankinë + Rruga Degëzimi djathtas, Bankinë" në vlerë

totale projekti 13,500,000 lekë (AB129-00-01-231) **(degjese publike sipas procesverbalit nr 625 date 06.11.2024)**

Gjithsej shtesa në buxhet, në zërin e të ardhurave të trashëguara **është 127,100,000 lekë.**
Ju propozojmë miratimin e shtesës së buxhetit.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!

Grupi i Menaxhimit Strategjik :

Drejtoria Financë –Buxhetit
Ervisa Çuko

Drejtoria e të Ardhurave Vendore
Donald Nushi

Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Publike e Zhvillimit Urban dhe rural
Mimoza Haxhiu

Drejtoria Juridike
Bedri Hida

Ndërmarrja Pasurisë Publike
Evis Qyra

Qendra e Arsimit
Muarrem Sharka

Qendra e Kulturës & Klubi i Futbolli.
Brizida Dervishi

KRYETAR I BASHKISË
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE